



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 732/005
Dt 11.05.2017

Bazuar në nenin 17, pika 3, dhe nenin 22, pika 4, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 5.5.2017, mori:

VENDIM

Për realizimin e investimeve kapitale nga kodi i projektit 14044- "Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së Universitetit", në shumë prej 380.000.00 euro, si në vijim:

1. Projekti për ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës së jashtme – ndërtimi i parkut botanik, në vlerë prej 260.000.00;
2. Projekti për ndërtimin dhe vendosjen e rrethojës në gjatësi prej 600 metra, në vlerë prej 40.000.00 euro;
3. Mjetet e mbetura në shumë prej 80.000.00 euro të ridestinohen me rishikim të buxhetit për furnizim me inventar për kapusin e ri universitar.

Arsyetim

Bazuar në Ligjin mbi Buxhetin nr. 02/L-125 për Universitetin e Mitrovicës, me plotësim të ndryshimeve nga MASHT, në emër të kategorisë ekonomike "investime kapitale" janë planifikuar 600.000.00 euro, prej të cilave 220.000.00 euro janë planifikuar për furnizim me pajisje për laboratorë dhe 380.000.00 euro për ndërtim dhe renovim të infrastrukturës.

Meqenëse projekti për ndërtim dhe renovim të infrastrukturës është dhënë në formë të përgjithësuar, drejtoria për buxhet dhe financa ka parashtruar kërkesë dhe propozim për definimin dhe strukturimin e investimeve kapitale, respektivisht për specifikimin e projekteve kapitale, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në këto që u thanë më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Drejtorit për buxhet dhe financiar të UMIB-it,
3. Zyrës së prokurimit;
4. Zyrtarit ligjor



Dr. sc. Sabri Sadiku

Kryesues i Këshillit Drejtues